	Total	55,946.23	1,841.53	(54,104.70)	-97%	14,648.48	18,599.67	3,951.19	27%	5,585.78	4,599.54	(986.24)	-18%
Total Sektori Shoqëror	Arka	-	-	-	0%	255.37	-	(255.37)	-100%	336.00	67.35	(268.65)	-80%
	Banka	447,371.77	291,842.31	(155,529.46)	-35%	49,382.03	82,041.58	32,659.55	66%	27,670.56	24,749.19	(2,921.37)	-11%
	Inkasnat	-	-	-	0%	-	-	-	0%	-	-	-	0%
	Total	447,371.77	291,842.31	(155,529.46)	-35%	49,637.40	82,041.58	6,697.06	65%	28,006.56	24,816.54	(421.87)	-11%

PËRFUNDIMI (pjesa e Inkasimit)

Si përfundim i kësaj pjese të raportit, vlenë të theksohet edhe njëherë se shuma totale e faturuar për periudhën JANAR-DHJETOR 2024 ishte në vlerën prej 3,301,771.97 euro, ndërsa inkasimi i realizuar i këtyre mjeteve të faturuara ishte në total në vlerë prej 2,667,691.79 euro, ku nëse krahasimin dhe analizën e bëjmë në përqindje, atëher del se përgjatë kësaj periudhe kemi arritur të inkasojm vetëm 80.80 % të mjeteve të cilat i kemi faturuar për klientët tanë.

3. SHPENZIMET

Një ndër faktorët kryesorë të analizës financiare të kompanisë, është edhe analiza e shpenzimeve të krijuara nga kompania gjatë aktivitetit të saj operues në kryerjen e shërbimeve për të cilat jemi të angazhuar ti kryejmë. Në vazhdim po i paraqesim shpenzimet e krijuara për periudhën vjetore JANAR-DHJETOR të vitit 2024:

Shpenzimet për periudhën Janar - Dhjetor 2023/2024

Tabela 14

Shpenzimet sipas llojit	2023	2024	Ndryshimi	%
Shpenzimet e Derivateve (1)	201,819.79	217,579.45	15,759.66	7.81
Shpenzimet e higjenes dhe byfes	2,279.45	2,566.69	287.24	12.60
Shpenzimet e Energjise Elektrike	5,942.35	5,412.81	-529.54	-8.91
Shpenzimet uji	188.69	621.07	432.38	229.15
Blerje/Shpenzime-Materiale te tjera, (2)	32,179.32	47,846.26	15,666.94	48.68
Shpenzimet per antarsi Pamkos	4,800.00	4,980.00	180.00	3.75
Mirmbajtje dhe riparime (3)	35,360.34	64,286.13	28,925.79	81.80
Shpenzimet per goma (4)	13,573.09	17,043.64	3,470.55	25.57
Kontrollimi teknik i automjeteve	1,025.42	1,072.03	46.61	4.55
Sigurime per automjete	7,193.54	8,909.84	1,716.30	23.86
Takse administrative	1,155.00	1,199.80	44.80	3.88
Takse rrugore	1,840.00	2,290.00	450.00	24.46
Takse Ekologjike	610.00	760.00	150.00	24.59
Takse komunale	408.00	470.00	62.00	15.20
Sherbime kontaktuale (5)	27,823.03	17,993.22	-9,829.81	-35.33
Deponia KMDK (6)	265,900.12	316,058.56	50,158.44	18.86
Web faqe, reklama	2,408.40	2,009.40	-399.00	-16.57
Transferime,udhetime,representacion (7)	686.19	3,121.31	2,435.12	354.88
Shpenzime internet dhe telefon	7,244.14	7,617.64	373.50	5.16
Provizion bankar (8)	7,522.36	6,513.35	-1,009.01	-13.41
Tatimi ne prone Ferizaj	528.76	-	-	-
Tatim ne prone Shtime	187.92	169.13	-18.79	-10.00
Pagat dhe shperblimet e personelit (9)	1,471,320.75	1,711,591.65	240,270.90	16.33
Kontributet pensionale të Ndërmarrjes	73,398.24	85,582.08	12,183.84	16.60
Shpenzime të tjera për personelin	4,379.28	5,320.79	941.51	21.50
Shpenzimet e qirasë (10)	10,500.00	13,922.83	3,422.83	32.60
Shpenzimet per perfaqesime	967.00	208.00	-759.00	-78.49
Gjoha dhe demshperblime (11)	5,000.00	5,700.00	700.00	14.00
Shp. Administrative & Financiare te tjera	24,231.75	12,385.28	-11,846.47	-48.89
Shpenzimet e mirembajtjes programit (12)	6,800.00	24,627.12	17,827.12	262.16
Ndihma Solidare	800.00	700.00	-100.00	-12.50
Gjithsej shpenzime	2,218,072.93	2,588,558.08	370,485.15	16.70 %

Shpenzimet për periudhën vjetore Janar-Dhjetor 2024 kapin shumën prej 2,588,558.08 €, ndërsa shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar ishin 2,218,072.93 € që tregon se shpenzimet e kësaj periudhe janë më të mëdha për 370,485.15 € apo shprehur në përqindje 16.70 %.

Nëse analizohet rritja e përgjithshme e shpenzimeve në periudhën vjetore Janar-Dhjetor të vitit 2024 krahasuar me vitin e kaluar 2023, vërehet shumë qartë se rritja kryesore e shpenzimeve për vitin 2024 ka rezultuar të jetë nga rritja e shpenzimeve të pagave për punëtorët e kompanisë e cila ka ndodhur me rastin e nivelizimit të pagave sipas koeficientit të aplikuar për të gjitha pozitat e punës sipas organogramit të kompanisë, gjë e cila ka filluar të aplikohet nga muaji Janar 2024, vendimit për rritjen e pagave prej 30 euro për të gjithë punëtorët e kompanisë e cila ka filluar të aplikohet nga muaji PRILL 2024 si dhe rritjes së shpenzimeve të deponisë KMDK që rezulton kryesisht nga rritja e tarifës së deponimit për 1 euro në ton më shumë krahasuar me vitin e kaluar. **Pra, vetëm rritjet e shpenzimeve tek zëri i Shpenzimeve për PAGA dhe tek zëri i Shpenzimeve për DEPONIN KMDK shkaktajnë rritjen e shpenzimeve të përgjithshme (370,485.15 euro) për afro 82 % më shumë krahasuar me vitin paraprak 2023 (periudha Janar-Dhjetor).**

Gjithashtu në rritjen e përgjithshme të shpenzimeve kontribuojnë edhe zëri i shpenzimeve të derivateve i cili ka rritje prej 7.81 % (15,759.66 euro më shumë) krahasuar me vitin paraprak, zëri Blerjet dhe Shpenzimet-Materialet e tjera ku ka pasur rritje prej 48.68 % (15,666.94 euro më shumë krahasuar me vitin paraprak) në të cilin zë ka pasur blerje të dy kamionetave, veshëmbathjeve për punëtorët si dhe disa printer për zyre, si dhe gjithashtu zëri i shpenzimeve për Mirëmbajtjen dhe riparimet e Automjeteve i cili ka pasur një rritje shumë të lartë përgjatë vitit 2024 dhe atë prej afro 82 % rritje (28,925.79 euro më shumë krahasuar me vitin paraprak 2023).

Sqarime:

(1) Shpenzimet e derivateve janë të përmbledhura për të trija njësitë, nëse i ndajmë këto shpenzime për njësi veq e veq atëherë, për njësinë punuese Ferizaj janë shpenzuar 152,174.41 euro, për njësinë punuese Shtime janë shpenzuar 32,916.25 euro, ndërsa njësia Kaçanik ka shpenzuar 32,488.79 euro për derivate.

(2) Zëri i shpenzimeve “Blerje dhe shpenzime të tjera”, iu atribuohet atyre shpenzimeve që krijohen në shpenzimin e vajrave të ndryshëm për Automjetet e kompanisë e të cilat dalin nga Depo e kompanisë, mjeteve të punës të cilat zakonisht blehen për nevojat e kompanisë e të punëtorëve të saj siq janë dorezat e punës, fshesat e dorës, lopata të ndryshme e materiale të këtij lloji të cilat janë të nevojshme për sektorin e operativës, materiale të ndryshme të furnizuara për ndriqimin e Autoparkut, mirëmbajtjes së sistemit të ujit, Furnizimit me materiale dhe produkte të ndryshme për nevojat e punëtorëve të kompanisë etj.

Në vlerën e cekur prej 47,846.26 euro të shpenzimeve tek ky zë i veçantë per periudhen Janar-Dhjetor 2024 si dhe në rritjen e këtij zëri krahasuar me periudhen paraprake të vitit 2023, kan ndikuar kryesisht 4 kontrata te furnizimit të lidhura përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, e të cilat janë: Furnizimi me veshëmbathje për punëtorët e kompanise në vlerë prej: 13,845 euro; Furnizimi me sistemin e siguris se Kamerave në vlere prej: 3,040 euro, Furnizim me 4 printer të rinjë për zyre në vlere prej 990.00 euro si dhe Furnizimi me dy Kamioneta në vlere prej 16,600 eurove.

(3) Shpenzimet e Mirëmbajtjes dhe Riparimit në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2024 janë 64,286.13 euro ndërsa ne vitin 2023 ishin 35,360.34 euro **që nënkupton kemi rritje të shpenzimeve për 81.80 % më shumë për këtë periudhë raportuese**, rritje e cila rezulton nga defektet e paraqitura tek Kamionet e Rinje Faun me presat dhe procesin e ngarkim-shkarkimit të kontenjereve, e për të cilin problem jemi detyruar të angazhohemi në mënyra vetanake si kompani që të bëjmë rregullimin e tyre përmes operatorit tenderues për mirembajtjen e Automjeteve edhe pse i njëjti Kamion ka qenë në sigurim per rregullimin e ketyre defekteve mirepo pas shumë tentativave qe kemi pasur askush nuk ka rezultuar te na kryej pune nga kompania qe e sigurojn mbulesen e ketyre defekteve sipas siguracionit. Poashtu defektet e ndryshme te paraqitura ne Automjetet e kompanisë, sidomos në sistemin e tyre hidraulik, në Llamella dhe korpa si dhe Servisimet e bera per Automjetet e kompanise sipas nevojave te paraqitura kan ndikuar poashtu në rritjen kaq të madhe të këtyre shpenzimeve.

Gjithashtu, sipas rekomandimeve të departamentit operativ të kompanisë se Automjeti FORD CARGO i cili paraprakisht ka qenë në Defekt, mund të rregullohet, atëherë është marrë vendim që të bëhet një analizë mbi koston e riparimit të tij dhe rikthimit të tij në gjendje të rregullt për të vepruar në teren, ku pas analizës së bërë **Automjeti është rregulluar dhe e gjithë kostoja e tij e rregullimit ka qenë në vlerën: 11,600.00 euro**

(4) Shpenzimet për Goma për periudhën Janar - Dhjetor 2024 kanë qenë më të larta për 25 % apo për 3,470 euro krahasuar me vitin paraprak 2023, duke treguar kështu nevojën më të shpeshtë të ndrrimit të gomave dhe riparimit të tyre e cila ka ardhur kryesisht si rezultat i terenit të keq të deponive ku janë bërë zbrazjet e kamionëve me mbeturina, në të cilat terene edhe kemi pasur dëmtime të gomave.

(5) Shërbimet Kontraktuale: zëri i shpenzimeve “Shërbimet kontraktuale” janë më të ulëta në këtë periudhë të raportimit vjetor Janar-Dhjetor 2024 në krahasim me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2023 për arsye se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 **kemi pasur një kontraktor të angazhuar në Asistimin dhe Eliminimin e deponive ilegale, dhe i cili ka kryer shërbime në vlerë prej: 15,500.00 euro (Pa TVSH) për të cilat jemi faturuar ne si kompani, dhe e cila vlere ka qene me e ulët në krahasim me vleren e të njëjtës kontratë që e kemi pasur vitin 2023 (vlere e së cilës ishte= 25,935.00 euro)**

(6) Shpenzimet e KMDK-së janë më të larta në këtë periudhë të raportimit vjetor Janar-Dhjetor të vitit 2024 në krahasim në periudhen e njëjtë raportuese të vitit 2023 për arsye se çmimi i faturimit për ton është ngritur për 1 euro më shumë në këtë periudhë nga KMDK-ja, krahas edhe rritjes se sasise se deponimit te mbeturinave e cila ka ndodhë në këtë periudhe raportuese.

(7) **Zëri i shpenzimeve “Transferime, udhetime dhe Reprerentacion”** ka pasur rritje ne kete periudhe raportuese Janar-Dhjetor 2024 krahasuar me periudhen paraprake te vitit 2023 per vleren 2,435.12 euro (354.88 % rritje), e cila rritje kryesisht eshte ardhe nga mbulimi i shpenzimeve te Kryshefit Ekzekutiv per pjesmarrjen e tij ne Panairin nderkombetar IFAT 2024 në MUNICH te Gjermanise, shpenzime te cilat jan te aprovuara nga Bordi i drejtorëve për mbulesë-Kompenzim.

(8) **Shpenzimet e Provizionit Bankar** janë më të ulëta në këtë periudhë të vitit, për arsye se pavarisist provizioneve bankare që kompania ka me rastin e transfereve dhe pagesave që ajo realizon, kryesisht ulja e këtyre shpenzimeve është për arsyen se deri në fund të çdo muajit për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2024 vlera e shfrytëzuar e Overdraftit ka qenë shumë e ulët në krahasim me periudhën paraprake 2023, duke cilësuar kështu se nga shfrytëzimi i overdraftit kemi pjesen me te madhe te shpenzimeve te krijuara si Provizion bankar.

(9) Rritjet më të larta të shpenzimeve në këtë periudhë shihet se janë tek pozicioni i shpenzimeve për PAGA, ku për **shpenzimet e pagave** në periudhën Janar - Dhjetor të vitit 2024 kemi shpenzuar 1,711,591.65 euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2023 shpenzimet e pagave ishin 1,471,320.75 euro. Shpenzimet e pagave në këtë periudhë JANAR-DHJETOR 2024 kanë qenë më të larta për 240,270.90 euro, ose shprehur në përqindje 16.33 %. Siq edhe u potencua më lartë, rritja e pagave ka ardhur kryesisht nga krijimi (aplikimi) i koeficientit te pagave si dhe nivelizimi i tyre për të gjitha pozitat e punës sipas organogramit të kompanisë dhe vendimit per rritjen e pagave prej 30 euro per te gjithë punetoret e kompanise.

(10) **Shpenzimet e qiras** janë më të larta për shkak që kompania e ka hapur edhe një pike të re të pagesave në rrugën Driton Islami - përball banesave të Elkosit, si dhe vlerës së tatimit në qira që kompania e paguan për çdo muaj.

(11) **Gjobat dhe dëmshtëpërblimet** si zë i shpenzimeve kanë pësuar rritje si shkak i disa ndëshkimeve që I kemi marrur nga inspektoriat i punes për ankesat e ngritura nga punetoret e kompanis pjese te sindikates per disa nga shqetesimet e tyre, konkretisht per vendqendrimin e punetoreve fizik i cili vend eshte mbyllur dhe kemi marre nje gjobe ndëshkuese prej 2500 euro (vendqendrimi tek objektet e vjetra te kompanise), nje denim e kemi marr me rastin e lendimit te punetorit Kemajl Tusha per mungesen e disa procedurave-dokumenteve qe inspektoriat i punes i ka cilesuar si shkelje dhe ky denim ka qene ne vlere prej 1000 euro e po ashtu nje denim tjeter me rastin e lendimit prej 700 euro e nje tjeter ne vlere prej 1000 euro si dhe një në vlerë 500 euro.

(12) **Shpenzimet e Mirëmbajtjes së programit:** janë shpenzime të cilat kanë pësuar rritje gjatë kësaj periudhe Janar – Dhjetor 2024 dhe atë në vlerë prej 17,827.12 euro, e cila rritje konkretisht është ardhë si rezultat i një kontrate të nënshkruar për Plotësim dhe Avansimin e Programit të Kontabiliteti, Faturimit dhe Pagesave me licenca shtese dhe produkte shtese, krahas edhe kontrates se mirembajtjes te cilen veqse e kemi aktive nga viti 2023.

Gjithashtu vlenë të theksohet se kompania për vitin 2024 ka njohur edhe disa shpenzime të tjera të cilat nuk janë të paraqitura në tabelën më lartë e të cilat nuk kan pasur efektin e daljes së parasë gjatë këtij viti, mirëpo disa prej tyre kan ndikuar në rezultatin financiar të kompanis për vitin 2024, e i cili rezultat është i paraqitur në Pasqyrat Financiare për vitin 2024 . Këto shpenzime janë:

- Korigjimet e llogarive të arkëtushme = **49,260.89 euro**
- Shpenzimet e Zhvlerësimit= **34,847.23 euro**
- Ndëshkimet (Kamatat) nga ATK-ja për borgjin e Akumuluar= **142,065.99 euro**

Shpenzimet për korigjimet e llogarive të arkëtueshme, kompania i ka njohur sipas vendimeve që ajo i ka në aplikim sipas rregulloreve të saj, dhe se këto shpenzime janë krijuar me rastin e rregullimeve të bëra në kartelat e klientëve të cilët janë faturuar nga kompania në mënyrë fiktive.

Shpenzimet e zhvlerësimit janë të njohura sipas rregullave me të cilat njihen këto shpenzime për Makinerit, Ndërtesat dhe Pajisjet që kompania i ka në dispozicion.

Ndëshkimet dhe Kamatat nga Atk-ja janë një shpenzim shtesë që kompanisë tonë i është krijuar me rastin e vonesave të shkaktuara në pagesat ndaj ATK-së dhe obligimeve të akumuluar ndaj saj.

Tabela 15: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas planit të biznesit:

Veprimtaria primare+sekondare	Te planifikuara Janar-Dhjetor 2024	Te Realizuara Janar-Dhjetor 2024	Diferenca	%
Fuqia Punëtore/Shpenz.per Paga	1,500,000.00	1,797,173.73	297,173.73	119.81
Karburanti	200,000.00	217,579.45	17,579.45	108.79
Riparimi/Mirëmbajtja	50,000.00	64,286.13	14,286.13	128.57
Shpenzimet (ptk,elektrike,gas etj)	15,000.00	16,218.21	1,218.21	108.12
Deponimi KMDK	290,000.00	316,058.56	26,058.56	108.99
Rexhistrimi, Kontrolla teknike, Taksa e Automjeteve	15,000.00	14,701.67	-298.33	98.01
Shpenzimet e autogomave	10,000.00	17,043.64	7,043.64	170.44
Shpenzimet e mirembajtjes se programit	11,000.00	24,627.12	13,627.12	223.88
Të tjera O&M	159,000.00	120,869.57	-38,130.43	76.02
Gjithsej shpenzimet	2,250,000.00	2,588,558.08	338,558.08	115.05 %

Siç mund të vërehet nga tabela e prezantuar më lartë kompania ka arritur që shpenzimet e parapara në planë të biznesit të realizoj në përqindje të përgjithshme prej **115.05 %**. Pra kompania ka realizuar shpenzime të përgjithshme për 15.05 % më shumë sesa sipas planifikimeve të bëra.

Si sqarim shtesë, tek zeri “Të tjera O&M”, janë të përfshira zërat e shpenzimeve: Blerje dhe shpenzimet e tjera, shpenz. e PAMKOS, shërbimet kontraktuale, për web faqe, për reprezentacion, provizionimet, tatimi në prone, shpenzimet e qiras, Gjobat, shpenzimet e tjera financiare dhe administrative si dhe Ndihamat solidare.

Raporti INKASIM/SHPENZIME

Nëse i krahasojmë shpenzimet për këtë periudhë Janar-Dhjetor për dy vite 2023/2024 në raportë me inkasimin për të njëjtën periudhë të raportimit **atëherë vijmë në përfundim se kompania ka qenë rentabile në mbulimin e shpenzimeve të saj**, apo më konkretisht kompania me Inkasimin e realizuar të mjeteve për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka arritur të mbulojë të gjitha shpenzimet e krijuara për këtë periudhë raportuese.

Më poshtë po ju prezantojmë në formë tabelare raportin shpenzime /inkasim për periudhën Janar-Dhjetor 2023/2024.

Viti	Shpenzimet Janar-Dhjetor	Inkasimi	Diferenca	%
2023	2,218,072.93 euro	2,400,066.92 euro	181,993.99	8.20 %
2024	2,588,558.08 euro	2,667,691.79 euro	79,133.71	3.05 %

4. LLOGARITË E PAGUESHME

Për të zhvilluar veprimtarinë normale për të cilën jemi të thirrur për ta bërë, kompania KRM “Pastërtia” Sh.A. ka marrëdhënie kontraktore dhe financiare me operatorë të ndryshëm prej të cilëve furnizohemi me pjesë dhe materiale të nevojshme për zhvillimin e punëve dhe proceseve në kompaninë tonë. Andaj, nga mosinkasimi i mjaftueshëm i mjeteve financiare nga faturimi i bërë, krijojmë obligime ndaj furnitorëve për të cilët nuk arrijmë që të ju bëjmë pagesa në kohë reale për furnizimet e bëra dhe kësisoj krijojmë akumulime të obligimeve ndaj furnitorëve përgjatë muajve të caktuar.

Kësisoj, nëse i analizojmë obligimet që kemi krijuar ndaj furnitorëve ndër vite atëherë gjendja e obligimeve ndaj furnitorëve më 31-Dhjetor 2024 është si vijon:

Tabela 16

SITUACIONI I FURNITORËVE 31.12.2024						
Nr.	Emertimi i furnitorit	Detyrimi i meparshëm	Shuma Debi (Pagesat)	Shuma Kredi (Blerjet)	Detyrimi	Pesha
<u>1</u>	Kompania per menaxhimin e deponive ne Kosove Sh.A	194,196.78	269,277.49	341,343.25	266,262.54	41.17%
<u>2</u>	KUVENDI KOMUNAL DREJT.EK FERIZAJ	175,934.76	470.00	470.00	176,934.76	27.20%
<u>3</u>	HIB Petrol SH.P.K.	60,004.80	224,881.52	252,004.59	87,127.87	13.47%
<u>4</u>	IMB Soft SHPK	79.00	15,639.00	29,060.00	13,500.00	2.09%
<u>5</u>	STARGRAF SHYTPSHKRONJA FERIZAJ	10,496.00	10,745.88	13,645.68	13,395.80	2.07%
<u>6</u>	DIELLI CONSTRUCTION & EQUIPMENT SH.P.K	2,356.00	59,672.00	69,146.00	11,830.00	1.83%
<u>7</u>	PRO-MIX NTP 600691431 FERIZAJ	16,631.30	6,235.00	.00	10,396.30	1.61%
<u>8</u>	PAMKOS OJQ PRISHTIN	10,772.00	5,780.00	4,980.00	9,972.00	1.54%
<u>9</u>	TELEKOMI I KOSOVËS SH.A. (VALA)	9,737.55	8,250.92	8,237.16	9,723.79	1.50%
<u>10</u>	Goma Pro SHPK	4,704.66	13,908.62	18,747.96	9,544.00	1.48%
<u>11</u>	N.T.P. "BETIMI"	.00	8,300.00	16,600.00	8,300.00	1.28%
<u>12</u>	SHPEND BERISHA FERIZAJ	6,000.00	2,400.00	2,400.00	6,000.00	0.93%
<u>13</u>	BALLKAN PETROL SHPK (Vajra)	2,053.36	13,481.20	15,479.00	4,051.16	0.63%
<u>14</u>	KRU "BIFURKACIONI" SH.A - Ferizaj	3,606.31	250.72	607.32	3,962.91	0.61%
<u>15</u>	Përmbaues Privat "Bardh B. Tasholli"	3,240.73	.00	.00	3,240.73	0.50%
<u>16</u>	Restauranti D ISTRIJA SHPK	.00	.00	3,150.00	3,150.00	0.49%
<u>17</u>	INTERGRAF SHYTPSHKRONJE FERIZAJ	4,000.00	2,000.00	.00	2,000.00	0.31%
<u>18</u>	SYRI I SHQIPONJES SHPK FERIZAJ	1,319.52	.00	.00	1,319.52	0.20%
<u>19</u>	AUTOGOMA DPZ FERIZAJ	1,119.36	.00	.00	1,119.36	0.17%
<u>20</u>	OZON SPACE SHPK	1,569.40	1,569.40	990.00	990.00	0.15%
<u>21</u>	D.P.Z. KIENZLE	811.00	96.00	60.00	775.00	0.12%
<u>22</u>	L & G SHPK Ferizaj	.00	.00	734.00	734.00	0.11%
<u>23</u>	KOHA GROUP PRISHTIN	589.00	320.00	320.00	589.00	0.09%
<u>24</u>	Dardha Solution	576.13	988.80	989.47	576.80	0.09%
<u>25</u>	GENI AUTOSERVIS FERIZAJ	420.00	.00	.00	420.00	0.06%
<u>26</u>	DPH RESTORANT KRISTALI	413.82	.00	.00	413.82	0.06%
<u>27</u>	UNIONI FINANCIAR SHPK PRISHTINE	527.47	512.00	334.00	349.47	0.05%
<u>28</u>	KEDS	300.15	5,852.40	5,847.33	295.08	0.05%

<u>29</u>	IFJB CAPITAL SHPK	313.89	542.00	460.50	232.39	0.04%
<u>30</u>	DENISI COLOR SHPK	.00	.00	185.01	185.01	0.03%
<u>31</u>	GANI ROSHA FERIZAJ	0.00	1040.00	1,215.00	175.00	0.03%
<u>32</u>	KUVENDI KOMUNAL SHTIME t SHTIME	610.99	649.40	169.13	130..72	0.02%
<u>33</u>	IT SOLUTION NTSH Ferizaj	.00	644.70	690.70	46.00	0.01%
<u>34</u>	Kompania Rajonale e Ujësjetës – PRISHTINA SH.A.	13.39	.00	24.19	37.58	0.01%
Gjithsej:		520,592.34	683,522.39	809,710.68	646,780.63	100.00%

Obligimet ndaj furnitorëve në këtë periudhë vjetore Janar-Dhjetor të vitit 2024 janë **646,780.63 euro** ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 2023 kanë qenë 536,572.29 euro, apo shprehur në përqindje **me 31.12.2024 obligimet ndaj furnitorëve janë për 20.54 % më të larta** krahasuar me periudhën paraprake 31 Dhjetor 2023, që nënkupton se përgjatë periudhës JANAR-DHJETOR 2024 kemi ngecur me pagesat ndaj furnitorëve si rezultat i mungesës së inkasimit në nivelin e duhur për mbulimin e ketyre pagesave, por edhe **si arsye kryesore ka qenë rritja e Shpenzimeve të Pagave**, e për të cilat shpenzime i kemi mbuluar për qdo muaj nga mospagesat e tjera të furnitorëve e kështu kemi shkaktuar vonesa në pagesa tek furnitorët tanë.

Vlenë të përmendet se kanë ekzistuar disa kartela financiare me furnitorët tanë përgjatë viteve të kaluara me saldo të borxheve me vlera minimale, e me të cilët kemi zhvilluar kontakte dhe kemi arritur të bëjmë barazimet reale të salldove të këtyre obligimeve. Disa prej kartelave financiare (Furnitorëve) nuk kemi arritur fare ti gjejmë ngase aktiviteti i tyre është shuar dhe se kanë mbyllur të gjithë biznesin, e pasiqe të gjitha ato saldo ishin shumë të vjetra, nësi zyre e financave kemi vendosur të bëjmë rregullimet e tyre.

Poashtu, Kompania KRM “Pastërtia” Sh.A. ka obligime të akumuluar për deklarimet në Administratën Tatimore në Kosovë (ATK-në), **të cilat më 31 DHJETOR 2024 janë në vlerë prej 711,188.00 euro (me ndëshkime dhe kamata)**, me të cilin institucion kemi marrëveshje të riprogramimit të borxhit me këste mujore mirëpo në përgjithësi gjatë periudhës JANAR-DHJETOR kemi ngecur me pagesa të këstit si rezultat i inkasimit të pamjaftueshëm të mjeteve monetare, konkretisht mospagesave të faturave nga ana e nivelit Komunal të Ferizajt si dhe destimit të mjeteve të inkasuara konkretisht në pagesat e pagave të punonjësve tanë. Vlenë të përmendet se vetëm në periudhën Korrik-Gusht 2024 janë paguar konformë marrëveshjes së riprogramimit të borxhit mbi 160,000 euro duke zvogluar kështu borxhin ndaj ATK-së për vlerën e 100,000 eurove vetëm nga 30 Qershori 2024 deri në 30 Shtator 2024 duke shfrytëzuar kështu Inkasimin më të mirë që kemi pasur këta muaj dhe destinimin e tyre në pagesat e ATK-së, por prap pas periudhës së Shtatorit 2024, kompania nuk arrinte të mbulonte në kohë këstin sipas marrëveshjes me ATK-në.

Siq edhe dihet, Kompania KRM “Pastërtia” Sh.A. ka në shfrytëzim një OVERDRAFT në Bankën Ekonomike në vlerë prej 100,000 euro, ku me datën 31 DHJETOR 2024 saldo e shfrytëzimit të mjeteve nga **Overdrafti ka qenë në vlerë -92,302.00 euro**. Përmes shfrytëzimit të këtyre mjeteve kompania arrinë të mbajë një lloj balance në likuidimin e pagesave mujore (shpenzimeve mujore).

4.1 Stoqet

Sa i përketë gjendjes së stoqeve të KRM “Pastërtia” Sh.A. me datë 31.12.2024 gjendja ishte si vijon:

Tabela 17

Produkti	Njësia	Sasia	Qmimi furnizues	Vlera
Nafta	L	258.00	1.17	301.86
V.Motorrik 10-40	L	126.00	3.39	427.45
V.Motorrik 15W-40 1L	L	28.00	3.39	94.92
V.Hidroll	L	180.00	2.69	484.25
V.Atef	L	51.00	2.94	149.84
SEA -90	L	50.00	2.28	114.04
Shampon per xhama	L	32.00	1.02	32.54
Glicerin	L	29.50	3.38	99.77
Adblue	L	200.00	1.50	299.00
Primol Antifriz koncentrat 1/1	L	147.00	1.27	186.86
Mast Lubrikues (Pristal Lithium)	Kg	34.00	4.89	166.40
TOTAL				2,356.93

Tabela e lartëshënuar tregon gjendjen e stokut për secilin produkt në depon e kompanisë, ku këto produkte kompania i mban për shkak të plotësimit të nevojave operative, në mënyrë që mirëmbajtja e automjeteve të kompanisë të jetë në nivelin sa më të mirë të mundshëm.

5. TË DHËNAT NGA OPERATIVA

Bazuar në të dhënat e pranuar nga operativa me qëllim të përpilimit të raportit po i pasqyrojmë të dhënat për sasinë e mbeturinave të dërguara në Deponitë Gurëz, Gjilan dhe Prishtinë dhe atë sipas Njësive Operative:

Janar – Dhjetor 2024 (Tabela 18)

Nr.	Muaji	Ferizaj (ton)		Shtime (ton)		Kaçanik (ton)		Gjithsej (ton)	Nr. i zbrazjeve
		Gurëz	GL – PR	Gurëz	GL - PR	Gurëz	GL – PR		
1	Janar	1,022.20	974.20	-	408.88	174.60	221.21	2,801.09	644
2	Shkurt	679.30	1,138.68	-	314.30	79.10	227.02	2,438.40	565
3	Mars	618.08	1,226.52	-	337.60	98.92	248.18	2,529.30	451
4	Prill	686.26	944.90	-	343.40	223.30	160.20	2,358.06	498
5	Maj	795.37	1,487.77	-	411.48	250.90	151.68	3,097.20	676
6	Qershor	624.30	1,391.70	-	377.92	254.60	132.85	2,781.38	616
7	Korrik	1,075.14	1,527.18	-	506.74	278.10	309.64	3,696.80	773
8	Gusht	1,085.98	1,771.62	-	146.78	426.47	566.22	3,997.07	908
9	Shtator	644.88	1,573.14	-	426.74	106.60	300.20	3,051.56	771
10	Tetor	608.00	1,595.54		414.80	137.44	277.64	3,033.42	685
11	Nëntor	545.00	1,343.80		362.72	258.50	98.19	2,608.21	608
12	Dhjetor	604.70	1,396.54		370.76	255.90	117.66	2,745.56	522
Gjithsej (ton)		8,989.21	16,372.59		4,422.12	2,544.43	2,810.72	35,138.08	7,717

Janar – Dhjetor 2023 (Tabela 19)

Nr.	Muaji	Ferizaj (ton)		Shtime (ton)		Kaçanik (ton)		Gjithsej (ton)	Nr. i zbrazjeve
		Gurëz	GL – PR	Gurëz	GL - PR	Gurëz	GL – PR		
1	Janar	642.20	1,208.96	-	375.18	242.60	111.26	2,580.20	625
2	Shkurt	363.80	1,150.75	-	288.20	209.70	70.65	2,083.10	546
3	Mars	481.70	1,364.54	-	354.38	236.90	111.31	2,548.82	643
4	Prill	558.84	1,254.40	-	351.02	226.10	111.04	2,501.40	590
5	Maj	864.36	1,146.20	-	392.88	310.20	97.16	2,810.80	687
6	Qershor	688.40	1,400.65	-	388.88	261.50	148.65	2,888.08	661
7	Korrik	1,428.60	1,100.04	-	465.36	307.26	175.85	3,477.11	772
8	Gusht	2,046.10	778.88	-	568.82	319.70	219.21	3,932.72	821
9	Shtator	1,072.10	1,005.06	-	399.42	287.30	118.87	2,882.75	692
10	Tetor	854,800	595,860	-	288,560	278,100	109,049	2,126.37	517
11	Nentor	1,311.450	1,055.920	-	450,120	251,000	115.602	3,184.09	686
12	Dhjetor	1,239.230	814,240	-	368,420	279,300	97.032	2,798.22	632
Gjithsej (ton)		11,551.586	12,875.500	-	4,691,240	3,209.660	1,485.686	33,813.67	7,872

Të dhënat mbi sasinë e grumbulluar të mbeturinave po që se i krahasojmë për periudhën e njëjtë për të dy vitet do të shohim se sasia totale e grumbulluar në periudhën Janar - Dhjetor 2023 shprehur në tonelata ishte 33,813.67 ton, ndërsa në vitin 2024 kjo sasi ishte 35,138.08 ton, për 1,324.41 ton mbeturina të grumbulluara më shumë krahasuar me vitin 2023. Vlenë të përmendet se nëse krahasojmë numrin e zbrazjeve të cilat janë realizuar në deponi në vitin 2024 është më i ulët në krahasim me atë të vitit 2023 për periudhën Janar – Dhjetor, që nënkupton se shtimi i numrit të makinerisë për operim në kompani ka reduktuar edhe stërngarkimin e makinerisë me mbeturina gjë që në të kaluarën ka reflektuar edhe në shtimin e defekteve në kamion shkaku i ngarkesës së madhe me mbeturina, njëkohësisht tregon se operativa ka qene me efikiente ne ofrimin e sherbimeve duke minimizuar keshtu edhe routat e udhetimit për në deponi me ngarkes minimale të mbeturinave.

6. ADMINISTRATA DHE BURIMET NJERËZORE

Përmes kësaj pjese të Raportit të përgjithshëm të punës, Raporti nga Zyra e Burimeve Njerëzore ka për qëllim të analizojë aktivitetet dhe performancën e Departamentit të Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2024, duke vlerësuar rekrutimin, zhvillimin, qarkullimin e stafit, pagesat dhe pajtueshmërinë me politikat e brendshme dhe rregulloret ligjore.

Analiza e Strukturës dhe Organizimit të Burimeve Njerëzore

- Numri total i punonjësve: 272 (sipas gjendjes në fund të vitit 2024 duke përfshirë edhe Bordin e Drejtoreve, Aksionarët dhe ata me Asistencë)
- Në vitin 2024, kompania ka bërë disa ndryshime në strukturën e departamenteve për të optimizuar operimet dhe rritur eficiencën e punës.
- Sistemime të pozitive: 4
- Punësime të reja: 20
- Pushime pa pagesë në faza mujore: 5
- Trajnime të realizuara të brendshme: Të gjithë punonjësit janë trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë nga “OZON SPACE SHPK“ .
- Gjithashtu trajnime të tjera të jashtme për Auditim
- Trajnimi i zyrtarëve të caktuar nga kompania për Mbrojtje dhe siguri në punë

Janë respektuar të gjitha rregulloret mbi pagat minimale, orët e punës dhe sigurimet tjera.

Disiplina dhe masat ndëshkuese

- Raste disiplinore: 10 raste
- Paralajmërim: 10
- Largime për shkelje të rënda: 4

Ankesa të punonjësve: Janë paraqitur 3 ankesa, të cilat janë adresuar sipas protokolleve të brendshme

-
- Numri i punonjësve që janë larguar: 16

Arsyet kryesore:

- Largime me dëshirë: 8
 - Përfundim kontrate (pension): 4
 - Largime nga kompania (për shkelje të rënda të detyrave të punës): 3
 - Me rastin e vdekjes : 1
-

Pagesat:

Pra, paga mesatare në kompani është rritur me 18.96% nga viti 2023 në 2024

Në vitin 2024, pagat në kompani kanë pësuar rritje të konsiderueshme. P.sh. paga e punëtorëve fizikë është rritur me 22.86%, ndërsa ajo e vozitësve është rritur me 10.64%. Administrata ka pasur rritjen më të lartë me 24.42%.

- Bonuset dhe incentivat:

- 85% e punonjësve kanë marrë bonuse dhe shtesa gjatë vikendeve dhe festave .

Në përfundim, viti 2024 ka qenë një vit me arritje të rëndësishme për Departamentin e Burimeve Njerëzore, duke përmirësuar proceset e rekrutimit, trajnimit dhe menaxhimit të performancës. Megjithatë, sfida të tilla si qarkullimi i stafit dhe nevoja për më shumë trajnime mbeten prioritetet për vitin që jemi tani.

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE TË KRM “PASTËRTIA”SH.A

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2024, respektivisht deri në fund të muajit Dhjetor 2024, Bordi i Drejtorëve me Ekzekutivin e KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj ka mbajtur, pesë (7) mbledhje të rregullta dhe një (1) të jashtëzakonshme dhe atë si datat në vijim:

1. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 06.02.2024
2. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 15.03.2024
3. Mbledhje e jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 25.03.2024
4. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 15.04.2024
5. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 30.05.2024
6. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 11.07.2024
7. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 01.10.2024
8. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 16.12.2024

7. ZYRA E PROKURIMIT

Përmes tabelës së mëposhtme mund të shihni punën e zyrës së prokurimit për periudhën JANAR-Dhjetor 2024:

K. Regj. e Mbeturinave " Pastërtia " SH.A.

RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE per VITIN 2024

Konform nenit 87.2.12 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së raportit:

PJESA I . IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues	
Lloji i Autoritetit Kontraktues	
Kodi buxhetor	
Adresa	
Kodi postar - Qyteti	
Tel. fiks/ Celulari /Faksi	
Emri i menaxherit të prokurimit	
E-mail adresa	
Adresa e webit të AK	

PJESA II .KONTRATAT E NENSHKRUARA PUBLIKE

Lloji i Buxhetit	Nr. i Prokurimit											
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	KRMFe-23-12477-1-2-1	Furnizimi me vajra për nevojat e KRM Pastërtia Sh.A.-Ferizaj		24.11.2023.	12.1.2024.	11.1.2024.		35,000.00	22,990.00	" Balkan Petrol " SH.P.K.		
1	KRMFe-24-102-2-4-7	Shërbime këshilluese ligjore dhe të përfaqësimit për nevoja të KRM Pastërtia Sh.A. Ferizaj			18.1.2024.	17.1.2024.		990.00	970.00	Zyra Ligjore e Avokatise " FERLEX " SH.P.K.		
1	KRMFe-24-240-2-4-7	Auditimi i pasqyrave financiare të KRM "Pastërtia" sh.a.-Ferizaj për vitin 2023			22.1.2024.	19.1.2024.		990.00	990.00	" ALBAUDIT " SH.P.K.		
1	KRMFe-23-14317-2-2-1	Shërbimi për kryerjen e sigurimeve të automjeteve të KRM Pastërtia sh.a. Ferizaj (ritenderim)		29.12.2023.	22.1.2024.	19.1.2024.		15,000.00	13,860.44	Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.		
1	KRMFe-23-14318-1-2-1	Furnizimi me veshembathje per punetoret e KRM Pastertia sh.a. Ferizaj (ritenderim)		29.12.2023.	29.1.2024.	25.1.2024.		15,000.00	13,845.00	" INFINITT " SH.P.K.		
1	KRMFe-24-1198-2-4-7	Përpilimi dhe nënshkrimi i pasqyrave financiare të KRM "Pastërtia" sh.a.-Ferizaj (rishpallje 2)			27.2.2024.	23.2.2024.		600.00	500.00	KAV & E Group SH.P.K.		
1	KRMFe-23-12444-1-3-6	Furnizimi me sisteme të sigurisë së kamerave për nevojat e KRM Pastërtia sh.a., Ferizaj,Shtime ,Kaçanik		10.11.2023.	28.3.2024.	27.3.2024.		5,000.00	3,039.20	CODEFUSION TECH SH.P.K.		
1	KRMFe-24-2597-1-2-1	Furnizimi me goma dhe mirëmbajtja e gomave për nevoja të KRM "Pastërtia" sh.a Ferizaj		25.3.2024.	16.5.2024.	15.5.2024.		40,000.00	39,979.00	Goma Pro SH.P.K.		
1	KRMFe-24-5132-2-4-7	Mirëmbajtja e web faqes së kompanisë KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj			29.5.2024.	28.5.2024.		990.00	988.80	Rilind Spahiu B.I.		
1	KRMFe-24-2596-5-2-1	Asistim në eliminimin e deponive ilegale dhe interne sipas nevojave të "KRM "Pastertia" Sh.A. Ferizaj		25.3.2024.	30.5.2024.	29.5.2024.		30,000.00	14,000.00	Muhamet Muçiçi		
1	KRMFe-24-5128-2-4-7	Shërbime reklamimi për nevojave të "KRM "Pastertia" Sh.A. Ferizaj			3.6.2024.	31.5.2024.		990.00	970.00	AL FACE L.L.C.		
1	KRMFe-24-3442-1-2-1	Furnizimi me dy kamioneta (te perdorura) per nevojat e KRM Pastertia sh.a	5.4.2024.	8.4.2024.	12.6.2024.	7.6.2024.		19,000.00	16,600.00	" N.T.P. " Betimi "		
1	KRMFe-24-10404-2-2-5	Plotësimi dhe avansimi i sistemit egzistues me module dhe licensa shtesë për sigurim të cilësishë së shërbimeve për kompaninë KRM "Pastërtia" sh.a. Ferizaj	25.9.2024.		5.11.2024.	1.11.2024.		19,000.00	18,500.00	" IMB Soft " SH.P.K.		
1	KRMFe-24-11669-2-4-7	Vlerësimi i risikut në vendin e punës dhe trajnimi i stafit për siguri dhe shëndet në punë	5.11.2024.		12.11.2024.	7.11.2024.		990.00	990.00	OZON space SH.P.K.		
1	KRMFe-24-12228-1-4-7	Furnizimi me Printer për nevojat e kompanisë KRM "Pastërtia" Sh.A. për të tri njësit e saj Ferizaj, Shtime dhe Kaçanik	19.11.2024.		4.12.2024.	29.11.2024.		990.00	990.00	STAR GRAF SH.P.K.		
1	KRMFe-24-12425-2-4-7	Vlersimi i aseteve levizëse jashtë përdorimit si dhe të aseteve tjera që janë jashtë përdorimit	22.11.2024.		4.12.2024.	29.11.2024.		990.00	980.00	PARALEL CONSULTING & APPRAISALS L.L.C.		
1	KRMFe-24-12420-1-4-7	Mirëmbajtja dhe furnizimi me aparate kunder zjarrit per nevojat e KRM "Pastertia" SH.A. për tri Njësit e saj Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime	22.11.2024.		4.12.2024.	29.11.2024.		996.00	972.00	" L & G " SH.P.K.		